

**AKT – THEMELIMI  
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR  
” ALBJON H 2001 ” SHPK**

Sot ne daten 06.04.2024 , une i nenshkuari :

**Festim Hoxha** , i datelindjes 14.03.1968 , lindur ne Stebleve, me banim ne Durres, i pajisur me leternjoftim nr.036841298 dhe nr.personal G80314080L,

Ne baze te ligjit nr.9901 date 14.04.2008 ”Per tregtaret dhe shoqerite tregtare” dhe ligjit nr.9723 date 03.05.2007 ”Per Qendren Kombetare te Regjistrimit”, kam vendosur te themeloj shoqerine me pergjegjesi te kufizuar ” **ALBJON H 2001 ”SHPK** .

**NENI 1  
EMERTIMI I SHOQERISE**

Shoqeria do te quhet ” **ALBJON H 2001 ”SHPK** dhe eshte person juridik shqiptar. Veprimtaria e saj rregullohet sipas neneve te ketij statuti dhe Ligjit 9901 date 14.04.2008, si edhe Ligjit per QKR-se .

**NENI 2  
SELIA E SHOQERISE**

Shoqeria do te kete seline e saj ne Durres, Lagjja 14, Rruga Liverpool, Objekti Nr.5. Shoqeria mund te krijojte filiale, zyra perfaqesimi, ne perputhje me legjislacionin shqiptar.

**NENI 3  
OBJEKTI I VEPRIMTARISE SE SHOQERISE**

Shoqeria do te kete si objekt te veprimtarise se saj:  
Hekurthyes.

Shoqeria sipas nevojave te aktivitetit ka te drejten e ushtrimit te çdo aktiviteti te ligjshem, te lejueshem per formen e shoqerise, e cila nuk ndalohet me ligj ( sipas nenit 7 te Ligjit Nr.9901, dt 14-04-08).

**NENI 4  
KAPITALI I SHOQERISE**

Kapitali i shoqerise ” **ALBJON H 2001”SHPK** eshte 100.000 Leke . Ky kapital perbehet nga 1 kuote dhe zoterohet ne masen 100% ,nga ortakun i vetem i saj, zoti Festim Hoxha.

**NENI 5  
KOHEZGJATJA E SHOQERISE**

Shoqeria do te zhvilloje veprimtarine e saj per nje periudhe kohore te papercaktuar.



## **NENI 6 ORGANET E SHOQERISE**

- Asambleja e pergjithshme.
- Administratoret.

### **ASAMBLEJA E PERGJITHSHME**

Asambleja e pergjithshme eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per ceshtjet e meposhtme:

- Percaktimin e politikave tregtare te shoqerise.
- Ndryshimin e statutit.
- Emerimin dhe shkarkimin e administratoreve.
- Emerimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe te ekspereve kontabel te autorizuar.
- Percaktimin e shperblimeve per administratorin, likuiduesin dhe ekspertin kontabel.
- Mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise.
- Zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit.
- Pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre.
- Perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve.
- Riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.
- Miratimin e rregullave proceduriale te mbledhjeve te asamblese.
- Ceshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti.

### **ADMINISTRATORET**

Administrator i shoqerise do te jete zoti Festim Hoxha , i datelindjes 14.03.1968 , lindur ne Stebleve, Shqiperi, me banim ne Durres, i pajisur me leternjoftim nr.036841298 dhe nr.personal G80314080L, i cili emerohet per nje periudhe 5-vjecare, me te drejte riprteritje te ketij afati.

Administratori mund te shkarkohet ne çdo moment nga asambleja , me shumicë të thjeshte te votave, me kusht që në mbledhje të marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30% të kuotave.

Statuti apo marreveshje te tjera nuk mund te perjashtojne apo kufizojne kete te drejte.

### **NENI 7**

#### **Shpërndarja e fitimit vjetor të shoqërisë**

Pjesa e fitimit që i takon secilit ortak nga vlera e fitimit vjetor të deklaruar në pasqyrat financiare të shoqërisë, vendoset të shpërndahet nga asambleja e përgjithshme.

Asambleja e Përgjithshme ka kompetencë t'u shpërndajë ortakëve pjesën e fitimit në raport me vlerën e kapitalit të regjistruar, që kuotat e secilit ortak përfaqësojnë. Po ashtu, Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë që një pjesë e fitimit vjetor të mos u



shpërndahet ortakëve, por këto shuma të përdoren për zmadhimin e kapitalit fillestar apo për qëllime të tjera, të cilat ajo i konsideron të dobishme për shoqërinë.

**NENI 8**  
**Prishja e shoqërise.**

Prishja e shoqërise

Shoqëria priset :

- a) kur mbaron kohezgjatja e parashikuar në themelimin e saj,
- b) me vendim të asamblesë së përgjithshme,
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit,
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723 datë 3.5.2007 për "QKR",
- d) me vendim të gjykatës,
- dh) për arsye të tjera, të parashikuara në statut.

**NENI 9**  
**Likuidimi i shoqërise.**

Në rast të likuidimit të shoqërisë, Asambleja e Përgjithshme emëron një likuidator, i cili administron shoqërinë deri në mbylljen e procesit të likuidimit.

Me vendimin e posaçëm të Asamblesë së Përgjithshme, të marrë me shumicë të kualifikuar, pasi janë shlyer detyrimet ligjore ndaj kreditorëve të shoqërisë, likuidatori shpërndan pjesën e mbetur të pasurisë së shoqërisë ndërmjet ortakëve. Kjo shpërndarje e fundit bëhet në raport me vlerën e kapitalit të regjistruar, që kuotat e secilit ortak përfaqësojnë.

Likuiduesit duhet të ftojnë kreditorët për të depozituar pretendimet e tyre për prishjen e saj. Shoqëria e publikon dy herë këtë njoftim, me një interval prej 30 ditësh, në faqen e saj të internetit, si dhe në faqen e internetit të Qendrës

Kombëtare të Biznesit. Në njoftim duhet deklaruar se pretendimet duhet të depozitohen brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të fundit.

**NENI 10**  
**Përfundimi i likuidimit**

Pas shpërndarjes së aktiveve të mbetura, likuiduesi e njofton Qendrën Kombëtare të Biznesit për përfundimin e likuidimit dhe kërkon çregjistrimin e shoqërisë.

Veprimtaria e likuiduesit nuk mund të kundërshtohet pas çregjistrimit të shoqërisë nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit.

**ORTAKU THEMELUES I SHOQËRISË " ALBJON H 2001 "SHPK**  
**Festim Hoxha**

